Vdekje fashizmit — Liri Popullit

Pošt. plaćena u gotovo
Taksa postale e paguene

RILINDJA

ORGAN I FRONTIT POPULLUER TE KOSOVES E METOHIS

DEL DY HERE NE JAVE:
T'EJTEN DHE TE DIELLEN

Redaksija Prishtine
Rruga Emin Duraku Nr. 1

PAJTIMI:
per 1 vit 192 din
— 6 muej 96 —
— 3 muej 48 —

Dorshkrimet nuk kthehen

Odgovorni urednik
Drejtori pergjegjes SEDAT DIDA

Vjeti IV Nr. 165 | PRISHTINE, e dielle 5 Dhetuer 1948 | Çmimi 2 dinarë

Kolektivet punuese ne Krahinen t'one korren suksese te mdhaja gjate garave te nandorit

Nji numer i madh kolektivesh punuese te Krahines t'one e priti diten e 29 nandorit-festen e revolucjonit t'one ... popullor, me rezultate te mdhaja pune, me planin vjetuer te realizuem e, ne shum vende edhe te tejkaluem. Njerezit t'one punues ne luftë me vetmohim ma te madh dhe tue i zhvillue garat socjaliste, kane mbrrijte me i ... garat edhe ma, te cilat jane ka metode e persersheme e punes ne Vendin t'one, kane mbrrijte, perveç perfundimeve te mdhaja punoje, edhe ngritjen e produktivitetit te punes. Njerzit t'one punues tue zhvillue gara socjaliste, tue e zhvillue vete-inisjativen konstruktive kane mbrrijte me permiresue prodhimin, me e organizue ma mire procesin e prodhimit, me perdore metoda te reja pune, me e zhdukur edhe ma teper punen sulmuese, novatorizmin dhe punen racjonalizuese.

Suksesi e kolektivave t'one punuese te mbrrijtuna ne gara ne ndere te Dites se Republikes, jane kontribut i madh ne kryemjen e detyrave te naraprune me Plan t'one pesvjeçar. Rezultatet e deritashme tregojne se edhe ato kolektive ku ende s'asht realizue plani vjetuer se do te realizohet ne tanesi, e keshtu do te krijohet baza solide per kryemjen e detyrave ne plan ne vjetin e ardheshem. Shembujt e kolektivave punues, te cilet e kane plotsue planin vjetuer ose t'ayne te cilet jane afrue per me e plotsue, tregojne se i tane populli i jone punues e ka kuptue ... e Planit t'one pesvjeçar dhe i asht perveshe punes me te tane ... per ndertimin e socjalizmit ne Vendin t'one. Çdo fitore e jone e re, [illegible]

[illegible]

perqind. Disa sektore te minjeres e kane plotsue dhe tejkalue planin e prodhimit vjetuer edhe perpara festes se Republikes s'one. Keshtu sektori i ... e ka plotsue planin vjetuer 11 dite para prmotimit te dhanun e 41 dite para afatit te caktuem. Pesvjetori i Republikes s'one u festue me gzim te madh nga i tane kolektivi punues i Trepçes. Me kete rast ne minjere u-ba nji manifestim i madh. Si merite per punen te vetmohueshme dhe per suksesin e mbrrijtun per realizimin e planit u deklaruen 232 puntor per sulmues dhe 149 te tjere u shperblyen me te holla qe kapin shumen prej 540.000 dinaresh.

Kolektivi punues i minjeres se magnezitit ne Golesh e ka plotsue planin e minieraleve te paperpunuem qysh me 5 nandor. Ne kete minjere zhvillohet lufte e perditshme per permirsimin e kualitetit, keshtu sod kjo minjere ka mbrrijte me permirsue ket [illegible]

[illegible]

Sipermarrja krahinore per prodhimin e gelqeres „Kaçanik" tue zhvi- [illegible]

Deklarim sulmuesish ne kombinatin e zejtarve ne Prishtine

Me rastin e festes se 29 nandorit ne kolektivin punues te kombinatit te zejtarve ne Prishtine asht mbajte konferenca e deges sindikale me te cilin rast u-ba deklarimi i sulmuesve, lavdrimi dhe shperblimi i puntorve, te cilet kane mbrrijte rezultate ma te mira gjate garave te nandorit. Per sulmues u deklaruen per heren e dyte Mlladen Nikoliqi, i cili rregullisht e ka tejkalue normen me 28 per qind, Bedri Salihi, po per heren e dyte, i cili e ka tejkalue normen me 20,64 per qind. Mandej jane deklarue sulmues Rade Gjuroviq, i cili e ka tejkalue normen m · 30,4 per qind dhe Dimitrijeviq Milorad i cili e ka tejkalue normen me 21 per qind. Mandej jane lavdrue dhe shperblye me te holla dhete puntor, te cilet e kane tejkalue normen prej 2 deri me 18 per qind. Ne mes te ketyne ndodhet edhe invalidi Bozhidar Jevremoviq, 85 per qind i paafte per pune, i cili e ka tejkalue normen me 6 per qind.

Kolektivi punes ka mbrrijte gjate garave te nandorit me e permirsue kualitetin me 7 per qind e shtetit i jane kursye 60 mije dinare. Disciplina ne pune me 10 per qind. Kjo asht mbrrijte ne saje te kujdesit te deges sindikale dhe te drejtoris se sipermarrjes per zhdukjen me kohe te metave dhe te gabimeve.

Ky kolektiv punues asht shque edhe n'akcjonet e punes qe jane ndermarre prej organizatave te Frontit, tue dhane 1.540 ore pune vullnetare.

Ne fund te mbledhjes ky kolektiv vendosi me iu shpalle gara kombinateve zejtare ne Mitrovice, Peje dhe fabrikes mobiljeve ne Ferizaj. Garat do te zhvillohen ne kuadrin e premtimeve te dhanuna ne ndere te Kongresit te Dyte te PKS.

—o—

Sipermarrja „Ishrana" e ka realizue planin i qarkullimit te mallit me 85 per qied e planin e furnizimit me peme e perime e ka tejkalue me 5 per qind

Ne konferencen sindikale qe u mbajte prane sipermarrjes „Ishrana" ne Prishtine u-shqyrtue puna dhe rezultatet e mbrrijtuna deri tash gjate garave te nandorit dhe u-konstatue se sipermarrja e ka plotsue planin e qarkullimit te mallit me 85 per qind, planin e furnizimit me peme dhe perime e ka tejkalue me 5 per qind e planin e sigurimit te rezervave t'ushqimit per dimen nuk e ka plotsue ende per 5 per qind.

Ne baze te sukseseve te korruna ne garat e nandorit dega sindikale ne bashkpunim me drejtorin e sipermarrjes i ka shperblye me te holla dhe i ka lavdrue 27 puntor.

Mureen fund punimet e sivjetshme te brigadave te rinis n'autostraden „Vllaznim - Bashkim"

Me 29 nandor, pervjetorin e krijimit te Republikes s'one Federative Popullore te Jugosllavis, u festue mbarimi i punimeve te sivjetshme te brigadave te rinis n'autostraden „Vllaznim — bashkim". Ne festim muren pjes, perveç 10.000 ndertuesave t'autostrades, antari i KQ te PKJ shoku Vicko Krstulloviq, ministri i punve botore Vllado Zeçeviq, dhe kryetari i Kuvendit qendror te Rinis popullore te Jugosllavis shoku Millan Neoriciq dhe shume te tjere.

Parakalimi i brigadave te rinis filloi me raportin e komandantit te Shtabit te pergjithshem, Ico Bllanusha, qe ja dha kryetarit te Kuvendit qendror te Rinis popullore te Jugosllavis shoku Miljan Neoriçiq. Ne parakalim u treguen ne mnyre figurative suksesi e 77.000 ndertuesve ne luften shtatmujore per kryemjen e detyrave te caktueme. Autostrada „Vllaznim-bashkim" ka qene farkatore e kuadrave te reja.

Mbas raportit, ndertuesat i pershendeti n'emen te Qeveris qendrore ministri Vllado Zeçeviq. [illegible]

[illegible]

Letra e ndertuesve t' autostrades „Vllaznim-Bashkim" dergue Marshallit Tito

[illegible]

ne kryemjen e detyrave te punes, kemi marre mbi vedi dhe e kemi krye detyrimin e aftesimit te ndertuesave t'Autostrades per pjesmarrje n'ekonomin t'one socjaliste dhe per punen ne ngritjen kulturale dhe arsimore ne katundin t'one. Jemi udheheqe nga fjalet T'ua, se komunistat e rinis ... te rijt popullore jane burim kryesor i kuadrave per industrin t'one dhe kemi aftesue, ne perçnjet punes n'Autostrade dhe kurseve, 1.043 strukturar, ... marator e minjere te ri. ... te ndret prej radhve t'ona i kemi dergue ne fabrika dhe punctorina qe te mesojne, qe t'a vazhdojne betejen per realizimin e planit te Titos, ne rradhet e para te frontit socjalist. Perveç ... e pesdhete udhheqsa te ri te bibliotekave, kino-operatoresh, udheheqsash te grupeve korale, grupeve diletante, kursesh analfabetike do t'a shtrojne dijenin e tyne te fituene n'Autostrade.

Perveç detyreve te gjana e te veshtira, te cilat i ka shtrue paranesh plani operativ nuk kemi harrue [illegible]

[illegible]

Riorganizimi i ri n'aparatin e tregtis ka me e zhvillue dhe e forcue tregtin dhe furnizimin e njerzve punues

[illegible]

Keshillat e qytetit dhe te rrethit, qysh ne fillim te ketij riorganizimi, duhet t'angazhohen, per me ... nder ... qe kane per te marre prej drejtorati te tregtis dhe te furnizimit te Krahines s'one, se per ndryshej nuk do te jene ne gjendje me ... ketij riorganizimi si duhet.

Zgjanim'i rrjetes se dyqaneve-detyre me randesi e tregtis s'one socialiste

[illegible]

Ne rrethin e Ferizajt asht realizue dhe asht tejkalue plani i akcionit te sivjem te pyllzimit

Akcioni i pyllzimit gjate vjeshtes se sivjme asht zhvillue me sukses ne rrethin e Ferizajt, ku plani jo vetem qe asht realizue ne kohen e duhun por asht tejkalue. Kjo pune asht mbrrijte ne saje te punes se vrullshme dhe te pjesemarrjes masovike te brigadave te rinis dhe te Frontit popullor. Plani asht tejkalue per 21.600 fidane.

N'akcionin e pyllzimit do te dallohen ... perfundime edhe ma te mdhaja ... ky akcion se mos nderprehet prej te ftohtit. Ne 73 hektare e parapame per t'u pyllzue, jane mbjelle fidane te shumta pyjore e sidomos fidane bagremi e te tjera.

Ne kete rreth asht tue vazhdue njikohesisht edhe akcioni per premjen e druve dhe i qelljes se rruhut. Plani i ketij akcioni asht realizue me 70% me gjithe pengimet e te ftohtit. Akcioni vazhdon.

82 vete ne mes te cilve edhe 12 femna shqiptare. Ne pune jane dallue te rejat H... Samiit dhe Lubnava Risliq.

A. Gurashi

—o—

Akcion i gjane pyllzimi ne katundin Mushnikeve

Organizata e Frontit popullor te katundit Mushnikove te rrethit te Prizrenit, ... [illegible]

—o—

Reorganizimi i bashkimit kooperativ te rrethit ne Vuçiterne

Ne keto dite muer fund riorganizimi i bashkimit kooperativ te rrethit ne Vuçiterne. Te gjitha sipermarrjet e formueme rishtazi kane fillue nga puna. Perpilimi i planeve asht krye n'kr e gjitha kooperativat bujqesore te rrethit por me vonese, e cila asht shkaktue nga mos angazhimi i duhun i nepunsave te bashkimit kooperativ te rrethit dhe te kooperativave bujqesore te vendit.

—o—

Nga vepriatarja e kooperativave bujqesore ne rrethin e Prishtines

[illegible]

Arsim e kulturë

Ne katundin Çaber katundaret i plotesojne vet te gjitha nevojet e shkolles

Asht hera e pare qe katundi Çaber e ka shkollen e vet ne gjuhen shqipe. Pushteti popullor asht interesue per se tepermi dhe e ka caktue ndertesen ma te pershtatshme per shkolle, vetem se ne fillim ka qene e pa rregullueme mire dhe e papastrueme. Mbas pak kohe, vete katundaret tue pa se ne shkolle do te mesojne femijt e tyne, nuk u-kursyen per te dhane çdo ndihme, ne menyre qe ajo te bahet sa ma e pershtatshme. Perveç ndihmave materjale ata nuk u-kursyen me marre pjese vete ne pastrimin dhe rregullimin e nderteses shkollore.

Njikohesisht, edhe mesuesi Bexhet Sadiku ka kallxue nji kujdes te veçante per shkollen e ketij katundi, i cili me ndihmat e mbledhuna ka organizue qe te ndertohen 12 banka shkollore, 2 tavolina si dhe me i plotesue te gjitha dritaret me xhamat e nevojshme. Lokali me gjithse asht i vogel, prap se prap po sheroen ma se miri per shkolle.

Asht per t'u-vue ne dukje se edhe nxanesit kallxojne interesim te madh per shkolle dhe me deshire te madhe i vazhdojne mesimet pa nderpremje.

E. Kadiu.

Per t'u permirsue notat ne te gjitha mesimet ne muejt e ardhshem te gjysem-vjetorit te pare, me rastin e pranimit te nji shumice nxanesish n'organizaten e pioniereve me 29 Nanduer, organizata e Rinis dhe ajo e pionierve muer mbi vedi qe ne bashkpunim me mesimdhanesit dhe me drejtorin e gjimnazit, t'i permiresojne ato ne perqindjen ma te madhe te te gjithe nxanesve.

R. J.

Puna ne gjimnazin shqiptar te Prizrenit gjate periudhes shtatuer-nanduer

Me 20 Nanduer muer fund puna dymujore e mesimeve ne gjimnazin shqiptar te Prizrenit. Simbas perfundimeve te mbrrijtuna ka dale ne shesh se puna nuk ka qene e kenaqeshme persa i perket notave te nxanesve nder landet e ndryeshme te mesimeve. Kjo dobsi pune rrjedhe nga se ne fillim te vitit shkolluer nuk jane regjistrue me kohe mjaft nxanes, e bile nji muej ma vone; sepse disa prind i kane pengue bijt dhe bijat e tyne qe te ndjekin rregullisht shkollen, qe sigurisht jane prej atyne qe ende s'e kane kuptue randesin e saje dhe, se ne fillim kane mungue disa fuqi mesimore dhe tekstet ma te nevojshme, te cilat po plotsohen vazhdimisht

Antaret e Frontit na shkruejne

Pse Shyqeri Bajraktari e mban zen robni bashkshorten e tije-deri dje mesuese

Ç' prej çlirimit te Vendit t'one, ne rrethin e Vuçiternes ka sherbye si mesuese shoqja Hateme Shala, e cila para gjashte muejsh u-martue me Shyqeri Bajraktarin prej Vuçiterne. Shoqja Hateme Shala ka qene njaft aktive dhe asht mundue gjithnji per perparimin e popullit, e sidomos per çlirimin e grues shqiptare nga errshaji i saj. Ajo ka krye tri kurse pedagogjike, nder te cilat ka lidhe afte[illegible] per te kryer detyren e mesueses me ndergjegje te paster. Deri para martesës, ajo sherbej pa nderpremje jo vetem mbrenda murreve te shkolles, por edhe me organizaten e grues antifashiste. Posa ajo u-martue, bashkshorti i saj Shyqeri Bajraktari e mbyll mbrenda kater murreve te shtepis, tue mos e lejue qe te dale asnji here e ndihmue, se lene ma qe te kryeje detyren e shejte te mesueses, ku qe[illegible] i Vuçiternes ka nevoje aq te madhe per mesuese shqiptare. Deshira e saje asht qe te sherbeje gjithnji per te miren e kolektivitetit, por fatkeqsisht s'mundet me e realizue ate, derisa bashkshorti i saj perpiqet me e shtype çdo deshire te saje, cka asht ne kundershtim me te drejtat qe i gezon femna ne Vendin t'one progresiv.

Me gjithe qe Shyqerin asht thirre per keshillim ne seksjonin e arsimit te keshillit popullor te rrethit, ai jo vetem qe s'asht binde per me e lejue bashkshorten e tij qe te kryeje detyrën e mesueses, por si njeri prapanik ne mentalitetet e vjetra asht pergjegje: „Une jame martue qe t'a kene gruen ne shtepi, e cila te merret vetem me punet e shtepis dhe, veç kesaj, une nuk dishroj dhe as s'pranoj qe gruen t'ime te mos shofin te tjeret".

Qendrimi i Shyqeri Bajraktarit asht i kjarte — anmiqesuer, per asht ne kundershtim me interesat e popullit i cili ka nevoje qe te zhvillohet sa ma shum ne pikpamje kulturo-arsimore dhe te zhduke nji here e pergjithmone mbrapambetunine e se kalumes. Populli perparimtar i Krahines s'one tashma e ka kuptue dhe po e kupton jeten e re qe do te gzoje ne Jugosllavin e re, i cili po i jep shkelm djta dites carshafit te si[illegible]. Trashigim i mbrapsht qe s'e len femnen te marre fryme lirisht, ndersa Shyqeri Bajraktari e mban bashkshorten e tij arsimtare ne burgun e zi. Vepra e tij ban qe ne vendin e Hatemes te sherbeje nji mesuese tjeter, e cila do te sherbente diku ngjeti ku ndihet nji nevoje e kefille.

Asht mire qe ket çashtje te t'a shqyrtojne mire organizatat masovike dhe te çlirojne nga erresina shoqen Hateme Shala, e cila po te mbese e ndryeme, me sigurí do te damtohet nga shendeti, mbassi e ka shijue lirin per disa vjete me radhe dhe asht mesuese qe te punoje jo vetem per shtepi, por edhe per masat e gjana popullore. Keshtu e don interesi i pergjithshem edhe personal i shoqes ne fjale, prandaj asht dam sikur mos te realizohen deshirat dhe qellimet drejte rruges perparimtare.

NGA BASHKIMI SOVJETIK

Ne tremujorin e trete plani i prodhimit industrijal asht plotesue me 107 %

Prodhimi industrijal ne Bashkimin Sovjetik asht tue u-rrite per çdo muej. Per tremujorin e pare te vjetit ne vazhdim plani i prodhimit industrijal ka qene plotesue per 102%, ne te dytin — 104% kurse ne te tretin asht realizue per 107%.

Dy muejt e parme te tremujorit te fundit kane shenjue sukseze te reja n'industrin socjaliste. Nji nga uzinat ma te mdhaja te metalurgjis sovjetike — Magnitogorsk, ka mberrijte ne shkrinjen e hekurit te papunuem e tet gjillut deri tash prodhimin ma te madh. Uzina, vetem me 19 Nanduer e ka plotesue planin e njimbedhete muejve dhe se deri me 17 Dhetuer ka me e realizue planin e vet te prodhimit vjetuer. Jane prodhue jashta planit me mija tona hekuri e çeliku. Ndermarrja metalurgjike te krahines Dnjepropetrovsk e ka shtue produkcjonin e vet, ne krahasim me vitin e kaluem per 53,8%. Ne te gjitha minjerat e thengjillit vazhdimisht asht tue u-rrite produkcjoni. Njikohesisht, asht rrite produkcjoni i energjis elektrike si dhe transportimit te mallnave me anen e ferovis. N'industrin e thengjillit te minjerave te BRSS lindore 5 kombinate dhe 20 trusta te thengjillit e kane realizue shum perpara afatit planin e tyne te prodhimit njimbedhete-mujor. Kombinatet ma te medha te Donbasit „Stalinugol" dhe „Voroshillovgradugol" e kane tejkalue planin ne nxjerrjen e thengjillit, ne krahasim me te njajten periudhe te vitit te kaluem, per 21%. Minatoret e minjerave te thengjillit kane marre persiper se per ket vjet kane me dhane jashta planit te parapame me qinda mija tona lande djegese. Keshtu minatoret e minjeres se Çelibinskit ne vend te sasis se premtueme prej 200 mije tona kane prodhue 2.051 tone thengjilli jashta planit. Kolektivet e mija fabrikave dhe t'uzinave e kane plotsue para afatit planin vjetuer te prodhimit te tyne. Ne ket shifer perfshihen edhe pjesa ma e madhe e fabrikave, ma se 200 sipermarrje te Lenjingradit, industrija e Letonis dhe te Talinis si dhe shum ndermarrje te tjera.—

Fiskultura dhe Sporti

Proleter - Lupçe Nikoliq 7:0

Ne lushen sportive te Prishtines me 28 te k. m. asht zhvilue ndeshja e foot-ballit per kampionatin e RP te Serbis ne mes te shoqnive sportive: Proleterit (Prishtine) dhe t'asaj te Lupçe Nikoliq (Aleksinac).

Fill mbas fillimit te lojes „Proleteri" sulmon ne porten kundershtare. Me ket rast vija sulmuese e vendasve leshon nji seri shansash per me e percjelle e pershendete rrjeten e miqve. „Proleteri" ne te dhetin minut e detyron portjerin e miqve me e nxjerre topin nga porta. Mbas pak kombinimesh »Proleteri« realizon edhe golin e dyte. Ne te njizetin minut Gjinali nalteson rezultatin e »Proleterit« nga penaltiu. Goli ma i bukur gjate kesaj loje ka ra ne te 30 minut, te cilin e shenon Ibrahimi me nji shut te forte prej nji largesije afer 20 metrash. Pjesa e pare e lojes perfundon 5:0 ne favor te »Proleterit«.

Ndersa ne pjesen e pare te lojes »Proleteri« dominonte fushen, ne pjesen e dyte lot mjaft dobet. Aleksinasit e kane marre inisjativen dhe perpiqen me mish e me shpirt per me paksue rezultatin. Difeza e »Proleterit« asht shque per nderhymjet e veta te sakta dhe per pasimin e topave preçize. Ne ket pjese te lojes vija sulmuese e »Proleterit« zhvillon nji loje individuale e shoesh tue ba kombinime te shkurta. Memzi keta ne te 30 minut realizojne te 6 gol dhe pak ma vone edhe te 7, golin e fundit.

Kjo loje shquhet per sistem e taktike nga te gjitha ndeshjet qe ka lueite shoqnija sportive e „Proleterit" gjate ketij kampionati. Kjo fitore duhet t'i nxisi edhe ma forte »Proleterin« si shoqni reprezentative e Krahines s'one per me naltesue pozitën e saje ne klasifikimin e pergjithshem dhe t'angazhohet ma teper per me e zotnue nji teknike e sistem ma te nalte te lojes. Referi ka qene objektiv.

Shkolla teknike—gjimnazi shqiptar 1:0

Me 2 dhetuer asht zhvillue ndeshja ndermjet shkollave te siperme per kampjonatin e shkollave te mesme. Loja perfundoj 1:0 ne favor te sholles se mesme teknike. Loja ka qene mjaft e gjalle e interesante.

I. V. SERGEJEV

Shkenca dhe bestytnija

(Vijon nga numri 162)

Gjuha e gjalle e folun tuen ne pergjithesi e ne vehte shum fjale, qe e kane burimin prej dukunive te bestytnis. Keshtu, shprehja e vjeter semundja asht hjeke si me dore, shpjegohet me faktin se te paret t'one kane qene te bindun se lengja mund te cherohet, tue e prekë te semurin me dorën e nji njeriut te „drejte" [illegible] „drejte" ka te njajten rranje te [illegible] „fjathte", e me ket rast d.m.th. [illegible] ai qe e din te verteten).

[illegible] edhe fjala kaq e thjeshte si „[illegible]" (ne rusisht-çerezvur), e ka [illegible] e vet qysh ne kohna te [illegible] te Rusis se vjeter, kur kufijt e sikletore te ndryshme jane shenjue me koj se drunit (rusisht — çurka), [illegible] (rusisht — zarbanda). Me kalim perej „kufinit" (rusisht — çur) domethane me e shkele kufinin. Prej [illegible] „mos derdhni me teprice ([illegible])" d.m.th. me ia nxjere [illegible] me e kalue kufinin.

[illegible], kuptohet, nuk mund te shpjegohen te gjitha aq thjeshte. Shum [illegible] te vjetra kane humbe te jane harrue, dhe, s'na shkon gjithmon per [illegible] te percaktojne lidhjet, qe kane [illegible] bestytnit, qe jane edhe sot.

[illegible] te besimeve te kota qe i [illegible] ka edhe ato ne karakter [illegible] per rrjedhimet e veta. Po [illegible] se ma asht semue femija: qe [illegible] kerkel, perdrathet: „i kane ra mesyesh. E dijshe"!

Do te mjaftonte sikur t'ipej „femia" te damtuem prej mesyeshit kur bubash ase 15 nepej nji lugez ricini, qe semundja ti hiqet „si me dore". Por „mesyeshi" enigmatik edhe sherohet me mjete enigmatike perkatese: te semundit shkymen unat e zjarmit, tue ia mugji me nji grumbull fjalesh te çuditshme e te pakuptim.

Sot, njerezit kane nji qendrim kritik kundrejt te gjitha ketyne punve, tue dijte mire, se si „mesyeshi", falli", shkrimja e plumbit, shuemja e [illegible] jane mbeturina te botëkupdimeve te vjetrueme te njerezve dhe te botës se mbrapambetun. Por, prap perpara dy—treqind vjetve simbas pikpamjes s'one jane sjelle seriozisht kundrejt ketyne fjalve bashe. Njerzit me „sy te keqij" jane padite per lidhje me dreqnit se ia kane shite shpirtin djallit. I kane djege ne turra drush, i kane hjedhe n'uje; i kane mundue me hekur te kuqun, sikurse ka mundhe simbas dokevet e zakonevet t'egra t'atyne kohnave.

Ato kohna nuk jane fort larg prej nesh. Gjykimi mbi shtrigat e magjistaret ka qene dukje e zakonshme ne shekullin e mesem. Ne shekullin e XVIII e bile edhe ne te XIX, kur kane pase fillue me leviz hekurat e para, tue ushtue, shum njerez nder dina vende i kane gjykue per lidhje me „djallin". Mirepo, edhe ne ditet t'ona ka ende njerez, te cilet besojne se ka dreqen, shtrigaj, perhindsha si dhe besojne n'aftesin e disa njerezve qe munden me i semue te tjeret, me e perhape murtajen nder kafshet etj.

Sa ma i padijshem e i pakulturuem qe te jete njeriu, aq ma teper asht i kapelluem prej bestytnis dhe jeton me frigen e perhershme ne boten e shemtueme bestytnish.

Larg qytetesh, nder katundet e braktisuna edhe sot mundemi me ndie se lopes i ka hike tambli, sepse asaj i jane ba sehire; se mund te „perfitohet dashunija" e njeriut qe e ka per zemer, ne qofte se i epet me pi „bar te veçant magjik" se me fall mund te ndalet rrjedhja e gjakut prej varre, me frymje apo me urdhe dhimbja e dhambeve.

Kur njeriu i merr vesh shkaqet e vertete te kesaj apo t'asaj çfaqjeje, kur t'aprovoi lidhjen e drejte ndermjet disa dukunive, at'here parafytyrimet e bestytnis, si me thane lidhjet gjoja ne mes te shkaqeve e te rrjedhimeve, fillojne me u-zhduke. Per me i provue lidhjet e drejta ndihmon shkenca, e cila merret me studimin e te gjitha dukunive te natyres. E zhvillimi i shkences asht ne lidhje direkte me zhvillimin e shoqnis: sa ma i nalte te jete rendi shoqnuer, aq ma shum dije kane njerzit, ka ma pak bestytni ne shoqni te tegille.

Mirepo, bestytnit prap se prap zhduken shum ngadale, shum ma ngadale se sa qe rritet shkenca dhe se sa zhvillohet shoqnija njerzore. Kjo shpjegohet me faktin se, parafytyrimet e bestytnis mbi boten, zakonet e bestytnis, doket, besimet e kota, jane krijue gjate mija vjetesh dhe, sikurse thote nji shkrimtar anglez, „ato i ngjajne pronit, i cili posa te hapi amen e vet vazhdon te rrjedhe gjate gjithe shekullit".

Rranja e bestytnis qindron ne mbrapambetunin e njerzve

Bestytnija e ka burimin e vet ne te kalumen e lashte, kur mendja e njeriut ka bredhe ne terrin e padijes, te pashpjegueshmenis, kur njeriu ka jetue ne frigen e perhershme perpara dukunive te panjoftuna e te tmerrshme te natyres — bumbullima, urragani, termeti. Bestytnija asht lindun i friges. Nuk ka mbete kot shprehja—frige bestytnije. Çdo gja qe njeriu s'ka mujte me ia shpjegue vehtes, i asht duke e çuditshme, misterjoze dhe i ka shtie frigen e bestytnis.

Kjo frige asht rrite nga dobesija e njeriut perpara fuqive te tmerrshme te natyres. Njeriu i eger ka qene i pa fuqishem para tyne, natyra e ka shtype me fuqin e vet. „Fuqit misterjoze" kudo i jane shfaqe ne menyre anmiqesore. Niveli kultural i njeriut te pare ka qene i mjerueshem. Eksperienca e tij ka qene e ngushte. Me gjithe ate, njeriu asht perpjeke simbas fuqive te veta me i dhane ndonji kuptim natyres, dhe dukunive te saja. Ai ka parashtrue, ne qofte se ai mundet me shkrepe shkendi, tue i ra gurit me gure, mandej dikush i pa dukshem, gja e mbifuqishme, qe ka nji qind here-fuqi ma te madhe, shkrepe shkendin gjigande-rrufen, e cila veton tmerrshem ne qiell. Njeriu ka mendue, ne se atij i shkon perdore, e ne se ai mundet, tue i nda gishtat per me derdhe ate uje ne toke, atehere dikush shum ma i fuqishem se ai mundet me shkaktue tallaze neper detna e oqeane, me i drejtue duhit dhe me leshue rreke uji prej qielli.

Keshtu, njeriu ka krijue simbas formes e ngjajshmenis se vet zotna misterjoze te tokes e te qiellës, te zjarrit e t'erresines, t'ujit e te bimve. Pak nga pak ai e ka mbushe natyren me qinda shpirtnash te ndryshme. Ndermjet te tyne ka pase shpirtna te mire e te keqij. Nder [illegible] e liqej kane jetue hyjet e ujit, nder [illegible] shtepija-te shtepis, ne pyje-te pyjeve, nder male-shtrigat [illegible] e maleve.

Neper pyje ka shpata s'ka ra, bestytnija ka krijue lutjet e para-t'egra drejtohesh shpirtnave te fuqishem perendive te natyres. Perveç ketyne zotnave-titan, zotnues te tokes, t'ujit, mprojtesa te votres, te gjalbut, te kuqe stalls, njeriu ka krijue n'imagjinaten e tij edhe shum zotna te veçanta mprojtesa te votres, te gjalbut, te [illegible]. Ai ka adhurue diellin, eren, ujin, zjarrmin, guret, drujt, kafshet e [illegible] ka trajtue shembelltyren e zotnave dhe asht perpjeke me i zbute me lute, tue kerkue ndihme per vehte, per t'afermit e vet, mprojtje prej [illegible], plotesimin e deshirave.

(Vazhdon)

Ne Junik u-formue kooperativa katundare e punes

Ne keto dite asht formue kooperativa katundare e punes ne katundin Junik te rrethit te Gjakoves qe asht katundi ma i madh shqiptar ne kete rreth. Ne konferencat qe jane mbajte para disa ditesh, te gjitha ekonomit shtepijake shprehen deshiren per t'u regjistrue ne kooperative, e cila do te jete e tipit te trete. Kjo do te jete ma e madhja kooperative katundare e punes e perbame prej shqiptarve dhe do t'i kete te gjitha kushtet e nevojshme per zhvillimin te shpejte. Perveç kesaj antaret e rij te kesaj kooperative jane tue e shqyrtue mundesin dhe po marrin masa qe ne vjetin e ardheshem t'a pajisin katundin me drite elektrike.

Katundi Livagje per se shpejti do te pajiset me drite elektrike

Antaret e kooperatives katundare te punes "Milladin Steviq" ne katundin Livagje po bajne perpjekje te vazhdueshme per perparimin sa ma te madh te kooperatives se tyne. Perveç punve te tjera ata sivjet kane ndertue nji shtalle te madhe per vendosjen e 60 lopve. Gjithashtu kane ndertue edhe godinen per puntorin si dhe po e ndertojne mullinin e kooperatives. Antaret e kesaj kooperative kane ble ne keto dite nji maqine dinamo dhe keshtu per se shpejti katundi Livagje do te pajiset me drite elektike.

Planin e mbjelljeve te vjeshtes e ka realizue me 98%, perkatesisht [illegible] 100% [illegible] per [illegible] 306 [illegible] e bukës, ndersa planin i mbjelljes gru[illegible] 70%.

Formimi i kooperativave te reja katundare te punes

Katundarija e jone punuese tue i pa te mirat e punes se perbashket dhe tue i pa subseset gjithnji ma te mira qe po i korrin kooperativat katundare te deritashme te punes, po vendos vullnetarisht per formimin e kooperativave te ketilla ne katundet e veta, ku po inkuadrohen vullnetarisht shumica dermuese e ekonominave shtepijake e sidomos katundaret e mesem dhe te vorfen. Keshtu sot kemi 44 kooperativa te ktilla dhe pritet qe deri ne fund te ketij vjeti numri i ketyne kooperativave te shtohet ne 50.-

Ne keto dite jane tue u-formue kooperativat katundare te punes ne katundet Sovtoviq te rrethit te Ferizajt, ne Popovc dhe Kernjin e Eperme te rrethit te Mitrovices. Keto i kane paraqite lutjet per regjistrim.

Kooperativa katundare e punes „Sloga" ne Llaplesel korre perfundime te mira ne punen e vet

Ne katundin Llaplesel te rrethit te Prishtines, qysh ne vjetin 1946 asht formue kooperativa katundare e punes „Sloga". Kjo ne fillim ka pase vetem 25 ekonomi shtepijake me 160 hektare toke. Mirepo, me saje te punes se perbashket dhe fryteve te korruna gjate ketyne vjeteve, kjo provoje se kooperativizmi asht forma ma e mire per perparimin e bujqesise dhe per perimnesimin e jetes se katundareve - antare te kooperatives. Katundaret e ketij vendit fillun me u regjistrue masovikisht ne ket kooperative, keshtu sod kjo numron 121 ekonomi shtepijake dhe 700 hektare toke. Perveç kesaj kooperativa sod ka 58 pene kafshe tavre, 58 plugje, 58 vilaqe, 20 maqina mihse, 18 maqina lidhse, mandej nji dizel motor per vadlije, puntorin farkatar me te gjitha veglat e duhuna, traktora dhe maqina te tjera. Kooperativa i ka kushtue gjithashtu kujdes te madhe edhe zhvillimit te blegtoris e veçanerisht rritjes se thive, keshtu qe aji sot disponon 100 krerish.

Lajme te shkurta nga Krahina

Peje:

Ne keta dite asht mbajte prane keshillit sindikal te rrethit te Pejes nji mbledhje me te gjithe kryetaret e sekretaret e degeve sindikale. Ne mbledhje asht shqyrtue puna e derritashme dhe sukseset e arrijtuna gjate garave te zhvillueme te nderit te Kongresit te Peste te PKJ dhe per festen e 29 nandorit. Me kete rast jane caktue edhe detyret ne lidhje me organizimin dhe drejtimin sa ma te mire te garave ne nderë te Kongresit te Dyte te PK te Serbis dhe te konferences se IV-te Krahinore te PK te Serbis per Kosmet. Per te pase pasqyre sa ma te kjarte ne lidhje me suksesat qe do te realizohen gjate garave qe po zhvillohen, jane marre masat e nevojshme dhe jane caktue detyret konkrete per nji evidence sa ma te perpikte.

—o—

Peje:

Kolektivi punues i sipermarrjes se transportit ne Peje e ka kremtue festen e 29 nandorit me fitore te mdha ne realizimin e detyreve me plan. Kolektivi e ka realizue dhe tejkalue planin vjetor para afatit te caktuem si dhe premtimet e dhanuna. Planin i transportimit t'udhetareve e ka tejkalue me 12% e atë te mallit me 38%. Veç kesaj sipermarrja ka arrijte me [illegible] 4,1% te karburanteve.

—o—

Ferizaj:

Sipermarrja pyjore „Nerodimlje" ne Ferizaj e prite festen e 29 nandorit me rezultate te mira te arrijtuna n'eksploatimin e pyjeve. Ne diten e 29 nandorit asht mbajte konferenca solemne e te gjithe puntorve pyjore ne vendin e punuit Godena Reka. Me ket rast u-deklarue 14 rranor per sulmues e 17 te tjere u-shpervjeu ne te holla si dhe 6 u fotoderen. Per shkak se kjo sipermarrje nuk ka mbajte ma pare evidence te rregullt, shpallja e sulmuesve u-ba per heren e pare ne diten e 29 nandorit.

SHAH

Dega sindikale e puntorve arsimtare te gjimnazit serb e shqiptar te Prizrenit para sa ditesh zhvilloi nji ndeshje shahut me oficerat e Shtabit t'Armates ne Prizren.

Ne ndeshje mueren pjese nga 11 lojtare, dhe perfundimi i lojnave qe ne favor t'arsimtareve 6:5.

Tue u mbeshtete ne te mirat e kesaj loje, e cila ka njikohesisht edhe qellim edukativ, kujtojme se asht mire qe me kete loje te merren edhe te gjitha deget sindikale tjera, te cilat te zhvillojne ndeshje miqesore ne mes te tyne.

Nga situata nderkombtare

Roli i „Planit Marshall" ne mendimet e nxitesave te luftes

Ne shtypin amerikan borgjez „Plani Marshall" quhet „program i rindertimit t'Europes". [illegible] „Marshall" „program i rindertimit t'Europes" [illegible]

Mirepo, te gjitha keto [illegible] Planit Marshall [illegible] rindertimit t'Europes [illegible]

[illegible] Planit Marshall [illegible] SH.B.A. [illegible]

Ne mars te ketij vjeti, kur asht shqyrtue Planin Marshall ne Kongresin [illegible]

[illegible] t'Europes lindore dhe kundra Bashkimit Sovjetik.

[illegible] „Plani Marshall" [illegible] kesaj ndermarrje. [illegible] „Planit Marshall" [illegible]

[illegible] SH. B. A. [illegible] t'Europes perendimore [illegible]

[illegible] ndihmen e Marshallit [illegible]

Sovjetet e Bashkimit [illegible] imperialistave amerikan [illegible] shtypit amerikan Borgjez [illegible]

[illegible] SH.B.A. [illegible] Frances [illegible]

[illegible] SH.B.A. [illegible] (SIB).

LAJME TE SHKURTA

Greva e puntorve te limajve mori fund me sukses

Greva e puntorve te limajve te Frances u perfundue me sukses. Ne mes te perfaqsuesave te sindikatit te puntorve te limajve dhe Ministris se punve publike u nenshkrue marreveshtja, ne baze te se ciles puntorve te limajve i u shtuen rrogat per 25 %.

Policija franceze i burgose udheheqsat e greves se marinarve dhe oficerave te marines tregtare

Tash nji muej rresht po vazhdon greva e marinarve dhe oficerave te marines tregtare ne limanin e Marsejit. Ministri i marines tregtare, Kolen, refuzon me diskutue mbi kerkesat e grevistave, ndersa organet p licore, perveç masave te zakonshme per shuemjen e greves, po burgosin udheheqsa te dalluem te Sindikatit te marinarve te marines tregtare. Ne qendren e sindikatit ne Marsej, jane burgose sekretari i pergjithesh m i Sindikatit te marinarve te marines tregtare dhe zavendesi i tij. Puntoret e shum sipermarrjeve ne Marsej kane fillue greva te shkurta ne shenj protesti kundra burgosjes s'udheheqsave sindikalista. Federata e marinarve dhe oficerave te marines tregtare ka ba proteste energjike kundra kesaj shkeljes se te drejtave sindikale nga ana policis se Zhil Mok-ut.

Represaljet e qeveris se Kej-it kundra minatorve francez

Me pretekstin e t'ashtuquejtunes „mprojtje e liris se punes", drejtorinat e minierave franceze te qymyrit dhe gjyqet e shkalles se pare i denojne grevistat, e sidomos ata grevista qe jane dallue gjate greves me shpirtin e tyne luftarak dhe me punen ne sindikate. Keshtu per shembull, ne bazenin e qymyrit Mozel, 1.200 minatore jane shlye nga lista rrogave. Ne bazenat e departmaneve Gar dhe Loare ne minierat Martine dhe Dekazvil, asht pushue nga puna nji numer i madh minatoresh. Nga bazenet e ndryshme te minjerave mrrijne lajme mbi arrestimet e reja te puntorve te minjerave dhe mbi nxerrjen e tyne para gjyqeve.

Mirpo, puntoret e minjerave jane tue e vazhdue me vendosje luften per lirimin e grevistave te burgosun ose te denuem. Delegacionet e puntorve te minjerave kane kerkue qe te kthehen ne pune te gjithe puntoret e pushuem, qe te lirohen te burgosunit dhe t'anulohen denimet. Ne shenj solidarsije me puntoret e minjerave, qe jane godite me masat e represaljeve, ne mbare Francen po vazhdon aksioni i mbledhjes se ndihmave per minatoret dhe per familjet e tyne.

Java e Spanjes se lire

Prej 1 deri me 8 dhetuer do te mbahet ne mbare boten java e Spanjes se lire. Inisjativen per mbajtjen e kesaj jave e ka dhane „Apeli i refugjatve te Spanjes", e ket inisjative e ka pranue sekretarjati i Federates nderkombtare te grave. Mbrenda kesaj jave ne te gjitha vendet t'organizohen mbledhje dhe manifestime masovike per keputjen e marredhanjeve diplomatike dhe ekonomike si edhe per izolimin e Spanjes se Frankos. Do te formohet nji delegacjon nderkombtar, i cili do te shk n ne Paris me ia parashtrue kerkesat e veta sekretarit te pergjithshem t'OKB, Trigve Li.

„Apeli i refugjatve spanjoll" ne letren e tij i lut grat e Jugosllavis qe t'a emnojne nji ose dy d legate, qe do te jene antare te ketij delegacjoni.